

# AKT THEMELIMI dhe STATUT i SHOQËRISË me PERGJEGJËSI të KUFIZUAR:

## “eDoktor”

Me cilësinë e ortakëve themelues:

**Z. Besnik Myftari**, atësia Aziz, lindur më 14.04.1968, në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. Ismail Qemali, Nd. 18, Ap.10, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal ID G80414170N,

dhe

**Z. Emil Andoni**, atësia Roland, lindur më 27.08.1983, në Maliq dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. Sheh Ahmet Pazari, Nd. 2, H.1, Ap. 102, Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim me numër personal ID I30827169E.

Mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe në veçanti në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “, i ndryshuar, dhe në Ligjin Nr. 131/2015 “Per QKB”, sot më dt. 16.12.2024 hartuan dhe nënshkruan aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë “eDoktor” SHPK.

Nr. tel. +355 692648098

Website: [www.edoktor.al](http://www.edoktor.al)

## KREU I

### Neni 1- Krijimi

Shoqëria “eDoktor” shpk, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

### Neni 2- Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “eDoktor” SHPK, është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar nga z. **Besnik Myftari** dhe z. **Emil Andoni**. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm me kapitalin e saj të nënshkruar dhe me të mirat e pasurisë së saj. Ajo në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakëve dhe as këta të fundit nuk mbajnë përgjegjësi personale për detyrimet që merr përsipër shoqëria.

Ortakët gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kanë dhënë në kapital.

### Neni 3- Selia

Shoqeria e ka seline në : Rruga “Barrikadave”, pall. Green Terrace, kati 2, ap.15, Tiranë.

## Neni 4- Objekti i veprimtarise

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat e mëposhtme:

### 1. Shërbime në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK):

- Projektimi, zhvillimi, implementimi dhe menaxhimi i infrastrukturave **cloud** për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave dixhitale.
- Zhvillimi dhe aplikimi i praktikave **DevOps** për optimizimin e proceseve teknologjike dhe operacionale.
- Projektimi, zhvillimi dhe menaxhimi i **faqeve të internetit, aplikacioneve mobile dhe ëeb, dhe integritimeve API.**
- Implementimi i sistemeve për **monitorimin e sigurisë dhe performancës** në kohë reale të sistemeve informatike.
- Ofrimi i shërbimeve të **sigurisë kibernetike**, përfshirë mbrojtjen e të dhënave, monitorimin e kërcënimeve dhe zbutjen e sulmeve kibernetike.
- Analiza, migrimi dhe integrimi i sistemeve informatike, si dhe projektimi dhe mirëmbajtja e programeve kompjuterike (softëare) për të gjitha platformat dhe sistemet.
- Realizimi dhe mirëmbajtja e **sistemeve ERP, CRM, HR** dhe zgjidhjeve tjera informatike për bizneset dhe individët.

### 2. Shërbime në Fushën e Shëndetësisë dhe Mjekësisë:

- Organizimi, ngritja dhe menaxhimi i **strukturave diagnostikuese, kuruese dhe qendrave ambulatorie**, si dhe ngritja e **spitaleve dhe klinikave.**
- Performimi i **analizave gjenetike, biokimike dhe mikrobiologjike** dhe ofrimi i shërbimeve të tjera laboratorike.
- Konsulenca, asistenca dhe menaxhimi në fushën farmaceutike dhe shëndetësore, përfshirë marketingun, regjistrimin dhe aksesin e produkteve mjekësore.
- Ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe konsulencës për individë dhe biznese, si dhe trajnime në fushën e mjekësisë dhe infermierisë.

### 3. Shërbime në Fushën e Marketingut dhe E-Commerce:

- Zhvillimi i **marketingut online**, përfshirë **SEO, menaxhimin e rrjeteve sociale**, dhe krijimin e **fushatave publicitare** për individë dhe biznese.
- Dizajni grafik dhe krijimi i **materialeve promociionale** për brendet dhe shërbimet e klientëve.
- Menaxhimi dhe zhvillimi i platformave **e-commerce** për tregti online, përfshirë integrimin me sistemet e pagesave dhe logjistikën.

### 4. Import, Eksport dhe Tregti:

- Importi, eksporti dhe tregtimi i pajisjeve elektronike, teknologjike dhe mjekësore, si dhe komponentëve të lidhur me to.
- Tregtia me shumicë dhe pakicë e pajisjeve mjekësore dhe farmaceutike.

### 5. Shërbime të Konsulencës dhe Trajnimeve:

- Konsulencë dhe studime në fushat teknologjike, ekonomike, farmaceutike dhe shëndetësore.
- Organizimi dhe zhvillimi i **trajnimeve profesionale**, përfshirë trajnime në teknologji, marketing online dhe zhvillimin e aftësive për të rinjtë.

### 6. Veprimtari Shtesë:

- Pjesëmarrja si ortak apo aksioner në shoqëri të tjera tregtare.
- Kryerja e transaksioneve dhe operacioneve me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, vendosja e pengjeve dhe hipotekave.
- Kryerja e aktiviteteve të tjera që nuk ndalohen nga ligji dhe që konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.

### **Neni 5- Kohezgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 6- Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota dhe zotërohet si më poshtë:

Nga ortakët z. **Besnik Myftari**, zotëruar i 1 (një) kuota që përben 50% të kapitalit të shoqërisë;  
Ortakët z. **Emil Andoni**, zotëruar i 1 (një) kuota që përben 50% të kapitalit të shoqërisë;

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tjerëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

### **Neni 7- Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.  
Zvogëlimi/zmadhimi i kapitalit realizohet me vendim të asamblesë së ortakëve.

### **Neni 8- Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

### **Neni 9- Organi Vendimmarres**



Asambleja është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Ortaket janë organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e ortakeve vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 10- Administrimi**

Administrator i shoqërisë është **z. Emil Andoni**, atësia Roland, lindur më 27.08.1983, në Maliq dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Sheh Ahmet Pazari, Nd. 2, H.1, Ap. 102, Tiranë, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim me numër personal I30827169E, emëruar në këto detyra për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakeve të shoqërisë.

#### **Neni 11-Kompetencat**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrase mbledhjen e ortakeve dhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

### **Neni 12- Përgjegjësitë**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaket që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

#### **Neni 13- Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përkrahimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 14- Bilanci i shoqërisë dhe dividendet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### **Neni 15- Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë që ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Neni 16-Fitimet**

Të ardhurat neto ( Dividenti ) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimit e pagesave ndaj të tregëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakëve të shoqërisë.

#### **Neni 17-Shpërndarja e shoqërisë**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikohet menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortaket.

Nëse ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 18- Likuiduesi**

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

### **Neni 19- Të drejtat e detyrimet e likuiduesit**

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare“, i ndryshuar, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t’i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

### **Neni 20- Përfundimi i likuidimit**

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar.

### **Neni 21- Bashkimi**

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

### **Neni 22- Ndarja**

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar .
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidarë për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" pa kryerjen e likuidimit.

### **Neni 23- Shndërrimi**

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit te saj në shoqëri aksionare  
Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

### **Neni 24- Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.



### **Neni 25- Mosmarreveshjet**

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

### **Neni 26- Dispozita përfundimtare**


Ky Akt themelimi dhe Statut u redaktua në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet me vullnetin e lirë nga ortaket themelues.

### **ORTAKET THEMELUES**

**Z. Besnik Myftari**

**Z. Emil Andoni**

Dt. 16.12.2024

Besnik Myftari  


Emil Andoni  
